

Letër e Hapur mbi Përmirësimin e Qasjes së Gazetarëve në Kuvendin e Shqipërisë

Drejtuar:

Z. Niko Peleshi, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë

Për dijeni:

Kryetari i Komisionit Parlamentar për të Drejtat e Njeriut dhe Mjetet e Informimit Publik

Z. Taulant Balla, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste

Z. Gazment Bardhi, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike

Z. Tedi Blushi, Kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë së Lirisë

Lënda: Shqetësime mbi propozimet për kufizimin e qasjes së gazetarëve në Kuvend

I nderuar z. Peleshi,

Ne, Rrjeti SafeJournalists, partnerët e Media Freedom Rapid Response (MFRR), Reporterët pa Kufij (RSF), dhe organizatat e lirisë së medias në Shqipëri, shprehim shqetësimin tonë të thellë lidhur me propozimet e fundit nga shumica parlamentare për të kufizuar ndjeshëm qasjen e gazetarëve në Kuvendin e Shqipërisë. Këto propozime, sipas raportimeve të gazetarëve, parashikojnë heqjen e filmimeve të pavarura në sallën plenare dhe zëvendësimin e tyre plotësisht me një transmetim zyrtar të vetëm, si dhe kufizimin e të gjitha ndërveprimeve midis deputetëve dhe medias në një hapësirë të vetme të përcaktuar si “doorstep”. Nëse zbatohen, një gjë e tillë do të eliminonte praktikisht kontaktin e drejtpërdrejtë dhe spontan mes gazetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur dhe do ta bënte llogaridhënien vullnetare.

Kufizime të tilla do t’ia hiqnin publikut një nga hapësirat e fundit për të mbajtur përgjegjës deputetët dhe ministrat. Ndërkohë që mbrojtja e komunikimeve private të deputetëve është një shqetësim legjitim, ajo nuk mund të shërbejë si pretekst për heqjen e kamerave të pavarura nga salla plenare apo për ndalimin e gazetarëve që t’u afrohen deputetëve në hapësirat e Kuvendit. Ne kemi ngritur më parë shqetësime për [regullat e reja të akreditimit mediatik](#) të miratuara nga Kuvendi në vitin 2021, të cilat tashmë kufizuan lirinë e lëvizjes së gazetarëve brenda Kuvendit dhe rritën varësinë nga transmetimet zyrtare. Që prej asaj kohe kemi dokumentuar [raste të përsëritura](#) pengesash dhe një model më të gjerë të [kufizimit të aksesit](#).

Në Shqipëri, konteksti i përgjithshëm mediatik e bën edhe më shqetësues këtë propozim. Përfaqësuesit e qeverisë dhe deputetët e shumicës rrallë mbajnë konferenca për shtyp apo marrin pjesë në debate televizive të pavarura, duke u mbështetur më shumë te komunikimi i kuruar përmes rrjeteve sociale apo materialeve audiovizive të parapërgatitura nga Agjencia për Media dhe Informim. Vonesat, refuzimet dhe centralizimi tashmë pengojnë qasjen në informacionin publik. Kuvendi ka qenë për këtë arsye hapësira e fundit institucionale ku gazetarët mund të pyesnin drejtpërdrejt dhe spontanisht përfaqësuesit politikë. Heqja e kësaj hapësire do të ishte një hap i rëndë mbrapa për lirinë e medias dhe llogaridhënien demokratike.

Ne ju bëjmë thirrje, z. Kryetar, të ndërmerri këto hapa:

- **Të zhvillojë një dialog të hapur** me gazetarët, organizatat e lirisë së medias dhe palët e tjera të interesuara për të rishikuar sistemin e akreditimit parlamentar në mënyrë që të balancojë privatësinë me transparencën dhe të garantojë akses domethënës.
- **Të përafroni akreditimin me angazhimet ekzistuese**, përfshirë Strategjinë e Kuvendit 2025–2030 dhe zotimet e Nismës “Parlamenti i Hapur” mbi transparencën, llogaridhënien dhe marrëdhëniet konstruktive me median.
- **Të vendosni protokolle të qarta për Gardën e Republikës** për të parandaluar pengesat arbitrare ndaj gazetarëve, siç është vënë re në vitin 2024, veçanërisht gjatë momenteve të tensionit politik.
- **Të ruani pika të shumta aksesit.** “Doorstep”-i mund ta plotësojë qasjen, por nuk duhet të zëvendësojë korridoret, lobet dhe oborret që mundësojnë pyetje spontane.
- **Të garantoni hapjen institucionale** duke lejuar filmimet e pavarura krahas transmetimeve zyrtare, duke publikuar në kohë oraret dhe gjithë informacionin parlamentar përkatës, duke forcuar shërbimin e shtypit të Kuvendit, dhe duke u angazhuar për konsultime të ardhshme me gazetarët dhe organizatat e lirisë së medias përpara çdo ndryshimi tjetër.
- **Të forconi transparencën e komunikimit publik** duke vendosur konferenca të rregullta për shtyp, të udhëhequra nga gazetarët, me pjesëmarrjen e Kuvendit, deputetëve dhe ministrave, të mbajtura disa herë në muaj.
- **Të krijoni një mekanizëm të pavarur apelimi** në mënyrë që vendimet për akreditim ose qasje të mund të kundërshtohen shpejt dhe në mënyrë të drejtë, duke garantuar trajtim të barabartë për të gjitha mediat e akredituara, përfshirë ato lokale, rajonale, online dhe formatet e reja të gazetarisë.
- **Të riafirmoni angazhimet e Shqipërisë ndaj BE-së.** Hapja parlamentare dhe liria e medias janë elemente themelore të Klasterit 1 në negociatat e anëtarësimit. Zbatimi i këtyre standardeve do të tregojë angazhimin e Kuvendit ndaj transparencës dhe llogaridhënies, ndërsa masat kufizuese do të dëmtonin besueshmërinë demokratike brenda dhe jashtë vendit.

Ne ritheksojmë angazhimin tonë për të mbështetur institucionet shqiptare në përmirësimin e lirisë së medias dhe të shprehjes, duke theksuar se mbrojtja e fortë e gazetarisë dhe e fjalës së lirë janë themelore për zhvillimin demokratik të Shqipërisë dhe rrugën e saj drejt integritetit në BE.

Nënshkrues:

Rrjeti SafeJournalists

Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës
Shoqata e Gazetarëve të Maqedonisë
Shoqata e Gazetarëve të Bosnjë-Hercegovinës
Shoqata e Gazetarëve Kroatë
Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Serbisë
Sindikata e Mediave e Malit të Zi

Reagimi i Shpejtë për Lirinë e Medias (Media Freedom Rapid Response)

Federata Evropiane e Gazetarëve (EFJ)
Free Press Unlimited (FPU)
ARTICLE 19 Europe
Instituti Ndërkombëtar i Shtypit (IPI)
Osservatorio Ballkani Kaukazi Transeuropa (OBCT)
Qendra Evropiane për Lirinë e Shtypit dhe Medias (ECPMF)

Reporterët pa Kufij (RSF)

Organizatrat e shoqërisë civile në Shqipëri

Qendra për Shkencë dhe Inovacion për Zhvillim (SCiDEV)
Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë (AJA)
Komiteti Shqiptar i Helsinkit (KSHH)
Këshilli Shqiptar i Medias (KSHM)
Gratë Shqiptare në Audiovizual (AWA)
Sindikata e Gazetarëve dhe Punonjësve të Medias (SGMP)
Res Publica
Shoqata e Gazetarëve Profesionistë të Shqipërisë (APJA)
Amfora
Faktoje
Unioni i Gazetarëve Shqiptarë (UGSH)
Qendra Shqiptare për Gazetari Cilësore (ACQJ)
Civil Rights Defender, Shqipëri
Citizens.al

Rrjeti i Raportimit të Diversitetit